

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-32-93

K 31


DHIMITER
KARAGUNI



TRETI I
GJESHES
NARE

891.783-32-83

K 31



S

DHIMITER
KARAGUNI

TREGIMI I
GJYSHES
NARË

~~56676~~ 1435

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJYKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktorë XHEVAT BEQARAJ
SOKOL JAKOVA
Piktor HIQMET AGOLLI

Tirazhi 10.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1971

Moti ndryshoi papritur. Dielli u ftoh. Qie-
lli dhe toka u mbështollën me petkun e mjer-
gullës. Era çirrej me potere dhe vërshëllente
nëpër të plasurat e dritareve. Shiu filloi të mur-
muriste në çati.

Gjyshja Marë doli jashtë dhomës. Pas pak
hyri me një krah dru dhe i vendosi në zjarr. U
ul te qoshja e vatrës dhe, si shtrëngoi shaminë
e zezë, që i mbulonte flokët e bardhë, thirri fëm-
ijët e shtëpisë:

— Sa të digjet ky krah dru, po ju tregoj
një ngjarje, e cila ka ndodhur vite më parë.

Gjoni, më i vogli, vrapoi i pari dhe u
ngjesh në prehrin e ngrohtë të gjyshes.

Gimi, Teuta, Miri dhe Nora rrethuan gjy-
shen Marë.

— Hë gjyshe, na trego — e nxiti Nora.

Gjyshja Marë zgjati dorën qetësisht dhe
kapi mashën, trazoi prushin dhe i fryu zjarrit.
Flaka përpiu krahun e druve dhe mori hov për-
pjetë.

Të gjithë prisnin në heshtje.

Gjyshja Marë filloi:

— Është historia e një djali të vogël, të zgjuar dhe guximtar, që ka nderuar fshatin tonë.

E quanin Gjergji. Në shtëpi kishte nënën, dy vëllezër dhe një motër. Nëna e tij ishte një grua zemërbardhë, punëtore që s'ja gjeje shopen. Lodhej dhe vuante shumë që të rrite kalamajtë. Gjergji e shikonte lodhjen dhe dëshpërimin e saj. Vërtet ishte i vogël, po mosha nuk e pengonte të mendonte si i madh. E ndihmonte të ëmën.

Mirit nuk ju durua, ja ndërpreu fjalën gjyshes:

— Po Baba i Gjergjit ku ishte?

Plaka ngriti kokën dhe treti shikimin larg.

— Këtu zë fill historia e Gjergjit. Baba i tij u vra si u ka hije burrave të malësisë.

...Gjergji u rrit me kujtimin e babës. Ai e ruajti atë kujtim, nuk e shqiti nga zemra. Ai eci në rrugën e tet.

Po më duket se ndodhet para syve të mi...
E, ç'djalë, për kokën e djalit...

Ishte ditë e bukur pranvere. Gjethi i lisit sa kishte plasur. Bushi dhe shqopa, drurë, që

kurrë nuk zhvishen nga gjethet, formonin një det gjelbërimi.

Dielli ndritte kudo. Gjithshka zbardhëllente. Vetëm pylli, shpella, rrëpira ruanin hijen. Çdo gjë brenda tyre dukej e ftohtë, e frikshme... Po edhe atje kishte jetë.

Thellë pyllit, në një lëndinë, rrethuar nga drurë dhe shkurre, rrjedh një prroskë me ujë të argjendtë. Gurgullon ëmbël e gjason me melodinë e një fyelli. Aty më tej, ndodhet një trung i rrëzuar nga era dhe i zgavruar vende-vende nga zjarri.

Mbi këtë trung ishte ulur Gjergji i vogël, që sapo i kishte mbushur katërmbëdhjetë vjetët. Fytyra e tij e hequr dhe e mprehtë, sytë e zez, që i vetëtinin, tregonin gjithë botën e tij të gëzuar. Rrobat e prera jo sipas trupit dhe opinjat e rënda i jepnin pamjen e një djali të rritur që nuk kishte hedhur shtat.

Qëndronte kokulur, i përqëndruar mbi një degëz shelgu të njomë. Duart i lëvisnin me shkathtësi për t'i nxjerrë, pa dëmtuar, lëkurën. Pranë tij, me kokën lart e me veshë të ngriatura si dy hinka, gati për të kapur çdo zhurmë të dyshimtë, qëndronte Murrua, qeni i tij besnik, leshtor, qafëgjatë, pak i krekosur. Më tej, buzë prroskës, kullosnin katër dhi me katër kecat. Në qafat e dhive, sipas moshës, Gjergji ki-

shte varur nga një zile dhe tingëllimin e tyre bariu i vogël e dallonte lehtë. Gjergji kënaqej me këngën e zileve.

Shënoi me majën e thikës disa vende mbi degë, pastaj filloi të bënte thellime. Fyelli ishte gati dhe e vendosi në buzë. I fryu. Lëvizi gish-tërinjtë e hollë. Tingujt e fyellit filluan të gurgullonin si prroska, si zilet e dhive, si fëshfëritja e gjetheve. Ai u gëzua dhe u mbështoll nga tingujt e zgjatur që nxirrte fyelli i tij. Po gëzimin ja ndërpreu Murrua, që lehu me të madhe: Ham!.. Ham!.. dhe u vërsul...

Gjergji ndjeu kërcitje shkarpash, po nuk arriti të kthente kokën prapa...

Para tij qëndruan katër burra me fytyra të vrejtura dhe të ashpra. Të parruar dhe të ndotur. Rrobat u ishin kthyer në zhele. Ishin të armatosur me pushkë, revole, bomba dore dhe thika.

Ata nuk kishin asgjë të përbashkët me ushtarët tanë. Ai e dinte se maleve dhe pyjeve, shpellave dhe përrenjve, zvarriteshin diversantë. Njëherë i erdhi mbarë që t'ja mbathte, po shpejt u përmbajt. Ç'ishte për të bërë të bëhej...

«Mysafirët» disa çaste e kundruan Gjer-

gjin nga koka te këmbët. E vështronin të hesh-
tur. Shikimet e tyre të ftohta sikur do ta shpo-
nin tejprtej, po Gjergji i priti këto vështrime
qetësisht.

Heshtja nuk zgjati shumë.

Një prej burrave ju afrua, i vuri dorën në
sup me dashamirësi dhe e pyeti:

— Më trego, djalë i mirë, si të quajnë?

Gjergjit, fytyra e atij njeriu ju duk e dja-
llëzuar.

Nuk ishte rasti për t'u menduar gjatë.
Gjergji e gjeti rrugëdaljen shpejt dhe u përg-
jegj:

— Më quajnë Pal.

Burri me fytyrën e djallëzuar vuri në buzë
një cigare dhe derdhi mbi Gjergjin një vësh-
trim të mprehtë, pastaj puliti sytë dhe përsëri
pyeti:

— I kujt je?

Gjergji e shikoi drejt në sy. Duhet të ishte
i matur në çdo përgjegje. Ia priti pa të keq:

— Jam djali i Mëhillit.

— Kurt, Pali qenka djali i mikut tonë.

Kurti u zgërdhi. Pas tij qeshën dhe të tje-
rët.

Gjergji bëri sikur nuk e kuptoi ç'deshi të
thoshte ajo e qeshur e shtirur. Ai vërejti një

gërshetim të shpejtë vështrimesh midis katër burrave. Kuptoi diçka...

Jakut i xixëlluan sytë.

— Mos, bre?.. Djali i Mëhillit je ti?.. Paskemi qenë me fat.

Gjergji nuk u trondit asnjë grimë nga kjo pyetje e papritur. Duke vënë buzën në gaz u përgjegj:

— Besa po... Jam gjaku i Mëhillit.

Jaku e përkëdheli Gjergjin me dashamirësi; pastaj u kthye nga shokët e tjerë dhe i ftoi të uleshin. Të katër u ulën shesh. Gjergji qëndronte në mes të tyre si pika në mes të rrethit. Në ato çaste, ju kujtuan fjalët e Vullnetit. Ai u kishte folur në shkollë për diversantët, të cilët vinin që jashtë shtetit e donin të rrëzonin pushtetin. Vullneti u kishte thënë:

«Armiku nuk është vetëm i ashpër, nuk kërkon vetëm të derdhë gjak dhe të ndezë zjarr, por është dhe dhelparak. Dhelpëria futet në lak me dhelpëri».

Kurti, i ngrysur, uli kokën dhe u zhyt në mendime. Jaku vijoi:

— Kështu, djalë i mirë, ti qenke gjaku i Mëhillit. Kjo na gëzon. Dhe paskemi qenë me fat. Dukesh djalë i zgjuar. Ti e merr vesh që ne jemi miqtë e babës tënd. Për atë jemi lodhur

deri këtu. Kemi nevojë të ngutshme të takohemi me të...

Gjergji e shikoi duke i dhënë forcë vetes, që të linte përshtypje se ishte shumë i interesuar për këtë miqësi...

Kurti, pasi thithi disa herë me etje cigaren, pyeti:

— Sa vjeç je, mor djalë i mirë?

Gjergji ndjeu se ju skuqën faqet.

— 14 vjeç.

Kurti shtriu këmbët përpara.

— Dukesh se je një cub i regjur... Sa i ngjan babës!

Gjergjit i shkrepinë sytë.

— Po, të gjithë më thonë se i ngjasoj.

Kurti, me një pamje fodulli, vazhdoi:

— Ashtu qoftë, ne gëzohemi të bëhesh si baba.

Gjergji vetëtimthi kaloi nëpër mend ndodhi të shkuara. Ndjeu t'i ndizej shpirti, por... Durim!

Jaku lëvizi ngadalë pushkën dhe hyri në bisedë.

— A ke parë të lëvizë njeri sot nga kjo anë?

— Jo, nuk kam parë — u përgjegj djalo-shi me një zë të sigurt dhe prerë. — Po të ki-

sha parë, kurrë nuk do të shtrohesha në bisedë me ju.

Kurtit i ndritën sytë. E vështroi djalin vëngër, e tha:

— Nuk paskemi gabuar. Ti qenke vërtet burrë me besë.

«Po. Ashtu jam — theksoi me vete Gjergji, — burrë me besë. Dhe besën ja kam dhënë kësaj toke».

U ul, mori fyellin dhe e ngjeshi në brez; e ngjeshi ashtu, sikur ta kishte armë.

— Në shtëpi është baba? — e pyeti Jaku.

— Nuk besoj. Në mëngjez mori udhë për nga fusha.

Kurti ndërhyri pa ja ndarë Gjergjit sytë laramanë.

— Ne duhet të takojmë patjetër babën tënd. Dhe këtë takim e kërkojmë prej teje. Lajmëroje të vijë sonte te Përroi i Ujikut.

— Kjo është gjë e kollajtë.

Tjetri vazhdoi:

— Do të nisesh që tani?

— Erë do të bëhem. Porosia është e qartë: babai im duhet të vijë tek ju. E prisni te Përroi i Ujikut.

— Hë, më të lumtë. E po hë, ç'pret, nisu!

— Po nisem. Dhe, sa tha këto, rrëmbeu shkopin e gjatë, që e mbante si në vend të kë-

rrabës, hodhi trastën në sup, e bëri të merrte rrugë.

Një nga diversantët, që gjer atëhere s'kish-te nxjerrë zë, i drejtohet Kurtit.

— Miku ynë s'do të zemërohet sikur t'i mbajmë një kec, se, e dini, nesër kemi festën e krishtit dhe...

Kurti nuk e zgjati. Mendimi i Sulës i erdhi pas oreksit. Urdhëroi të kapnin një kec larush që ishte më i plotë nga të tjerët. Dhe kur Sula vuri dorë mbi kecin, Gjergji shtrëngoi grushtin dhe, pa vetëdije, i shpëtoi:

— Mos bre...

Kurti e pa me inat.

— Çfarë the?

— Të katër kecat janë femra — tha djali si me turp dhe shpresoi se kështu do të fshinte zemërimin që e kapi në çast.

— Baba yt s'çan kokën për një kec, madje do t'i bëhet qejfi se miqtë e tij do të festojnë ringjalljen e Krishtit.

— Po, besa, ashtu është — u korigjua Gjergji, — baba s'kursehet për mikun. Gjithnjë thotë: «bujrum, bukë e kripë e zemër». Pra, edhe për ju s'do kursehet...

Kurti pyeti:

— Kush t'i ka dhënë këta keca, baba?

— I kanë pjellë dhitë.

Sula ja plasi të qeshurit.

— Mos gënje, or mistrec. Është zoti i madh e i vërtetë që t'i ka falur...

Keci lëshoi një zë therës. Gjergji e vësh-troi vjedhurazi dhe shtrëngoi nofullat.

Kurti e kërcënoi përsëri:

— Pse nuk flet?

Gjergji shtangu nga kjo kthesë e papritur. Shpejt e hoqi mendjen nga keci dhe, sikur të mos kish ndodhur gjë, pyeti:

— Ç'farë jeni ju?

Të katër qeshën me të madhe.

— More, pyetje prej të zgjuari është kjo? Ne të muarëm djalë të mënçur, kurse ti... akoma nuk ditke?.. — tha Kurti me një zë tallës dhe ju drejtua Jakut: — tregoji djalit se ç'jemi ne!

Jaku njomi buzët me majën e gjuhës dhe kthehet nga Gjergji:

— Dëgjo, djalë i mirë, mbaje mend, ne jemi mbrojtësit e fesë dhe të kanunit, luftojmë kuqaloshët që tallen me zotin dhe me ligjin tonë, që kanë rrëmbyer gjënë e tjetrit dhe ua kanë dhënë të tjerëve... Po të kërkosh të dish më shumë, thuaji babës tënd të të tregojë...

Gjergji mbylli sytë përgjysmë dhe tundi kokën.

— Don Françesku ynë i dënon ata që marrin gjënë e tjetrit pa pyetur.

Kurti u prish në fytyrë dhe shtrëngoi pushkën pas trupit.

— Ç'këlysh paske qenë ti. Dhe Don Françeskun po na tregon?

— E kam dëgjuar disa herë në kishë, kur flet për jetën e jetëve, për ringjalljen e Krishtit, për parajsën dhe ferrin.

Jaku ja preu fjalën:

— Mirë, ne do të marrim një kec me lejën tënde; të premtojmë se mot do të të sjellim një dhi.

Gjergjit i pikoi në zemër kur dëgjoji blegërimën e kecit, në ato duar. Keci po e shikonte si me lutje dhe po i kërkonte ndihmë për ta shpëtuar. Po djaloshi nuk mund ta ndihmonte. Me zemrën e vrarë u nis drejt shtegut. Pas pak u zhduk si era midis shkurreve të dendura. Pas tij vrapuan dhitë dhe kecat. Murrua çante i pari.

U ndal pranë një burimi për të shoshitur se ç'duhej të bënte. Mëhilli, që Gjergji e bëri babë, ishte miku i tyre. Po a ishte e vërtetë kjo? Gjergji mendoi dhe tha me vete:

— Jo, kjo është dhëlpëria e diversantëve.

Përsëri filloi të mendonte. Këputi një fije bari dhe filloi ta përtyppte me dhëmbët e tij të

bardhë dhe të fortë. Pa pritur pyeti: ç'duhet të bëj?

Ai e njihte pyllin pëllëmbë për pëllëmbë, dinte çdo skutë dhe vend të fshehtë, çdo shteg dhe monopat. Ata i thanë:

— E presim babën të vijë sonte te Përroi i Ujkut.

Gjergji pëshpëriti me vete:

«Ky është mashtrim. Po, po, mashtrim. Jo ... Unë nuk duhet të largohem nga pylli pa rënë në gjurmë të tyre. Ata janë diversantë. Diku, këtu midis pyllit do të gjejnë një vrimë që të fshehin kokën. Te Përroi i Ujkut ata nuk do të shkojnë».

U ngrit dhe hodhi vështrimin përreth. Pa Murrin. Zgjati dorën dhe e përkëdheli në qafë, i tha të qëndronte me dhinë, të mos largohet asnjë pëllëmbë prej tyre.

Pa e bërë të gjatë, zbriti poshtë përroit dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, fluturoi brinjës përtej. Doli te Shkëmbi i Shqipërisë dhe ju qep faqes që të nxjerr te Praku i Erës. Ecte si një ketër dhe i bindur se ata do të kalonin në atë Prak, sepse ishte i vetmi shteg kalimi asaj ane.

Gjergji ndoqi rrugën më të vështirë, po që ishte më e shkurtëra. I duhej të arrinte te Praku i Erës para se të kalonin ata.

Zuri vend midis shkurreve të dendura e fierit të gjatë dhe ra në heshtje...

Këtu qëndroi gjatë. Nuk u mërzit, as nuk i humbi shpresat. Koha rridhte me përtesë. Ai rrinte dhe priste. Rreth e rrotull mbretëronte heshtje, një heshtje e plotë, që vetëm rrallë e ndërpriste cicërima e ndonjë zogu. Po sikur ata njerëz të mos kalonin andej?

Në pritje dhe në heshtje njeriu mërzitet.. Mërzitet akoma më shumë kur ka një punë të ngutshme.

«Unë jam betuar se do të ndjek rrugën e babës. Kush do të ma falë mua në qoftë se largohem prej këtej pa gjetur se nga shkuan diversantët? A do të kem sy e faqe të dal para shokëve? Çfarë do t'i them mësuesit tim? Po kur të takoj Vullnetin? Po nëna ç'do të më thotë? Vëllezërit dhe motrat do të më quajnë frikacak. Sa turp...»

Në mes mendimeve dhe qetësisë së madhe ai dëgjoi fërfëllima të lehta. Pas pak, në veshët e tij erdhi dhe një rrahje sëpate e ngadalshme. Rrahja sa vinte bëhej më e fortë. Dëgjoi edhe zhurmë hapash, që shoqëroheshin me kërcitje shkarpash të thata. Priti dhe pak. Gjoksi filloi t'i ulej dhe t'i ngrihej me të shpejtë. Ndali fry-

mëmarrjen dhe mblodhi të gjitha forcat që të kapte çdo zhurmë. Ngriti pak kokën. Pa Jakun që doli te Praku i Erës. Në çast u ul dhe u zhyt në mes të gjelbërimit. Qeshi dhe tha me vete:

— Nuk gabova.

Përsëri ngriti kokën. Jo larg tij qëndronte Jaku. Ai hundëpoçi me kokën si shinik. Duke u bërë një me tokën tha:

— Ah, or Jak. Jak o dhelparak, tani nuk të ndahem po s'ta futa kokën në lak.

Dëgjoi dhe disa pëshpëritje. Fjalët nuk i vinin të qarta. Gjergji mblodhi të gjitha forcat dhe u bë vesh i tëri.

Midis pëshpëritjeve dalloi të qeshurën the-rëse të Kurtit dhe pas tyre fjalët:

— Kur të dëgjojë Mëhilli sonte, se e presim te Përroi i Ujkut, do t'i mbushen poturet.

Gjergji ndjeu një kënaqësi ngazëlluese. I i doli ashtu si dyshoi vetë. Legjenda Mëhill, mik i tyre, u dogj.

Sula shtoi:

— E ç'të mbushur pa... Fëmijët janë lajmëtarë të mirë.

Kurti pyeti:

— E, Jak, ndjehet gjë?... Ku duhet të presim?

— Nuk dëgjon rrahjen e sëpatës? Ai pret shënjën tonë që të afrohet.

Kurti hodhi vështrimin mbi Sulën dhe Bi-
bën.

— Duhet të fshihemi diku... Kurse Jaku të
japë shënjen. Qëndroni në gatishmëri për çdo
të papritur...

Gjergji shqiptoi i inatosur:

— Derrat, kanë frikë edhe nga lëkura e
tyre.

Të katër u shpërndanë dhe zunë vend larg
njeri tjetrit. Jaku lëshoi një vërshëllimë të fortë.
Asaj ju përgjegj një blegërimë. Pastaj sopata
nisi të rrihte më shpesh dhe më me forcë.

Gjergji luajti pak nga vendi dhe u zvarrit
disa hapa. Shtriu krahët dhe me duart e tij të
shkathëta hapi degët e shqopës që kishte për-
para, duke fshehur fytyrën midis gjethëve.

Syri i zuri një burrë të gjatë me mustaqe
të trasha, kurrizdalë, shpatullvarur. Ishte ve-
shur me një xhaketë ushtarake. Në dorë mbante
sëpatën. Ecte me kujdes që të mos shkaktonte
asnjë zhurmë. U ndal midis shtegut dhe hodhi
vështrimin përreth. Ai lëshoi një blegërimë.

Gjergji u bë njësh me shkurret. La hapur
një dritare që të shikonte ç'ndo të ndodhte më tej.

Blegërimës ju përgjegj një zë bretkose. Kjo
u përsërit disa herë. Të katër dualën nga vendet
e tyre dhe u avitën në heshtje te Selimi...

Selimi shkopsiti xhaketën dhe mblodhi këmbët kryq.

— Kam disa orë që pu ju pres, mendova se nuk do të vinit.

Kurti krojti fytin.

— Ke të drejtë. U vonuam pak, se pritëm një nga miqtë tanë... Ai na solli dhe këtë kec.

Gjergji, i vëmendshëm, pritte të dëgjonte emrin Pal dhe... ç'do të thuhej më për të. Po biseda e tyre rrodhi gjetkë.

Selimi kërciti gishtërinjtë dhe lëpiu buzët.

— Gjë e njomë. Ku keni rënë më të?

Jaku mbylli një sy dhe tundi kokën.

— Ne kemi miq kudo. E kush nuk na ndihmon... Ja, edhe me mish të njomë na ushqejnë.

— Po, ashtu është, miq kemi boll.

Kurti ndërhyri papritur dhe pyeti:

— Na trego ndonjë gjë të re. Ç'bëhet andej nga fshati?

— E njëjta gjë. I gjithë fshati është ngritur në këmbë dhe kërkon kooperativë. Ata që janë kundër numërohen me gisht.

Kurti mblodhi buzët. Jaku shtrembëroi fytyrën me urrejtje. Sula çapeleu sytë dhe Biba shfryu në të shara.

Jaku pështyu përtokë dhe pyeti:

— Po ti ç'ke vendosur të bësh?

Selimi ja ktheu me mërzi.

— As unë nuk e di. Të qëndrosh në heshtje, keq. Të dalësh kundra, më keq. Të hysh në kooperativë, është katran fare, më mirë vdekje..

Biba bëri kryq.

— Mos u bëftë kjo... Dreqi ju marrtë me gjithë kooperativë!

Kurti e shikoi shtrembër. Vështrimi i tij ishte një qortim, që të mos fliste më. Pastaj u kthye nga Selimi dhe tha i qetë:

— Ti duhet të hysh në kooperativë, madje të jesh nga të parët. Nuk duhet të lësh asnjë gjurmë dhe shënjë se je kundër komunistëve, merr vesh, apo jo?

Selimi, i prekur në sedër nga ajo që tha Kurti, foli:

— Mos është thënë të bëhem komunist? Jaku ja priti.

— Mos të bëhesh komunist, po të shkrihesh me komunistët. Pasi t'ja arrish këtij qëllimi, nxit të tjerët të minojnë veprën e komunistëve. Për këtë qëllim kemi ardhur deri këtu. Më kup-ton?

Selimi krojti kokën.

— Edhe pa qenë në kooperativë ashtu po veprojt.

Kurti thithi me etje tymin e duhanit.

— Bukuri, vazhdo të punosh kështu. Ç'kemi ndonjë të re tjetër?

Selimi filloi të tregonte gjendjen e kishës, frikën që e kishte kapur Don Françeskun se mos e shpronësonin dhe e linin në rrugë të madhe.

Kurti e shikoi me inat dhe i tha prerë.

— Lëri këto lajme, na folë për forcat ndjekëse, ku ndodhen dhe nga lëvizin. Kush është i armatosur nga populli dhe ç'flitet për ne...

— Forca duken kudo. Vështirë të gjesh njeri pa armë. Edhe fëmijët janë të armatosur.

Sula kuiti.

— Dreq!

Jaku pështyu me urrejtje.

— Po sot të ka zënë syri gjë këtej?

— Gjithë mëngjezin qëndrova në vëzhgim dhe, para se të vija këtu, kontrollova përreth. Nuk pashë asnjë ushtar.

Sula u çlirua nga ankthi i frikës.

Kurti buzëqeshi.

— E paske syrin pishë. Mirë thonë, se Selimit nuk i shpëton gjë. Nuk ja ha qeni shkopin. Të kemi mik, mor qerrata, dhe prandaj të duam...

Jaku deshi ta forconte sigurinë:

— Kush e di nga të afërmit se ke ardhur në pyll?

— Gruaja, mundet edhe ndonjë nga fëmijët e mi.

— Po nga bashkëfshatarët?

— Unë askujt nuk i tregova se për ku nisesha. Por kjo nuk më siguron plotësisht se, dreqi e di, ndonjë dhe mund të më ketë parë. Sot njerëzit kanë nga katër palë sy...

— Prapë e prishe, o Selim! — Nxitoi të thoshte Sula.

Biba rrinte e dëgjonte si i shushatur. Jaku i mbërtheu shikimin:

— Ç'më je bërë kruspull dhe po më rri si guak. Ngrehu dhe qëndro roje atje përtej.

Kurti ndezi cigaren dhe, pa i ngritur sytë, tha:

— Selim, mos i merr për të keq fjalët dhe pyetjet e Jakut. Kemi dhe ne hesapet tona. Po, që këto hesape të na dalin mirë, duhet të mendo-hemi dhe të përgatitemi. Ti na fole për kooperative. Tani dëgjo nga ne. Kemi vendosur të vrasim një, ose më shumë, si të na vijë për mbarrë, nga ata të çakërdisurit që thërresin për kooperative...

Gjergjit deri këtu nuk i kishte shpëtuar asnjë fjalë. Kur dëgjoi qëllimin e diversantëve, ju ndez një dëshirë e zjarrtë dhe i erdhi të hidhej mbi ato egërsira për t'i shqyer me thonj. Shtrëngoi dhëmbët dhe grushtet. Në trup i kaluan rrëqethje. Qetësoi veten dhe largoi mendimet. Vazhdoi të dëgjonte me kujdes ashtu si dhe më parë.

Kurti tha:

— Në mbrëmje, me ne, do të bashkohen edhe disa të tjerë. Pastaj do të vish edhe ti. Kur të jemi grumbulluar do të nisim punët tona.

Selimit i ndriti fytyra dhe sytë i qeshën. Luajti vendit dhe tundi kokën.

Kurti nuk e preu fjalën. Po toni i zërit të tij ra. Gjergji tani dëgjonte me vështirësi fjalë të shkëputura.

— Kërkojmë dhe... para se të shkosh në shtëpi... aty do të bësh edhe një punë tjetër...

Selimi hapi sytë dhe u bë gati të pyeste se ç'duhej të bënte. Po Kurti nuk e la.

— Dëgjo këtu, se ta them unë dhe mos u ngut... prej këtej do të shkosh... Njerëz të armatosur... Përroi i Ujikut... Kupton?

— Po. Sa bukur i keni menduar, zoti Kurt.

Kurti u largua pak nga Selimi dhe u krekos.

— Ta pret mendja, punët bëhen me mend... Nisu. Të presim të vish aty afër mesnatës... tek Përroi i Keq... E di se ku është?..

Selimi qeshi nën buzë.

— Vend cubash, midis gëmushave dhe shqopës ku veç sëpata çan rrugë.

Në qoftë se çdo gjë e ke të qartë, nisu! Mos harro të sjellësh bukë dhe lajme të reja.

Gjergji, duke parë Selimin që u ngrit, tha me vete:

— Po, po... pikë merak u mos kini. Bukë dhe lajme të reja do t'ju sjell unë. E çfarë buke se, bukë që nuk e keni ngrënë asnjëherë.


Selimi hodhi sëpatën në sup. Pa bërë hapin e dytë, Jaku e ndali.

— Një minutë. Mos u ngut të ikësh se ke kohë. Kur të vish në mbrëmje te vendi që të thamë, mos bëj asnjë hap përpara. Lësho disa blegërima me ndërprerje dhe prit. Kur të dëgjosh zërin e bretkosës, ndërpre blegërimën për disa çaste dhe lësho një zë çjerrës, ashtu siç çirret zogu i natës...

Selimi lojti kokën me shenjë pohimi. Eci drejt vendit ku kishte lënë kafshën. E ngarkoi me dru dhe u nis për rrugë.

Edhe pas largimit të Selimit, Gjergji nuk lëvizi nga vendi. Përsëri s'e ndau kontrollin mbi diversantët. Vendosi të qëndronte deri sa të mësonte drejtimin dhe strofkën ku do të futnin kokën. Pastaj kishte dhe një arsye tjetër që ai duhej të qëndronte: ç'do të bisedonin ata pa qenë Selimi?

Dhe me të vërtetë banditët vazhduan të bisedonin, fjalët e tyre derdheshin lumë. E sa



gjëra po dëgjonte Gjergji. Qeshi i kënaqur.

«Nuk ma hodhën dot. Kecin laraman nuk do të kenë kohë ta hanë. Ringjalljen e Krishtit nuk do ta festojnë. As këta, as Don Françesku që kushedi sa herë u ka dhënë bukë dhe lajme. As Selimi nuk do të marrë shpërblimin e premtuar. Dredhia nuk u shkoi. Ah, ju... sa të pabesë që jini! Dhe te miku juaj nuk kini besim. I latë takim në vend tjetër, ndërsa vetë vendosët të strehoheni te Shpella e Minjve...»

Diversantët u ngritën dhe filluan të hiqnin këmbët zvarrë. Ata dukeshin si hije të ftohta nate. Biba mbante shtrënguar kecin laraman.

Gjergjit i pikoi zemra gjak. S'i vinte mirë ta shikonte. Vështrimin e hodhi përtej Prikut të Erës, Pa diversantët që po hynin në atë tunel të gjelbërt.

Me një frymë, djali arriti te burimi, ku kishte lënë dhitë, kecat dhe Murrin. Dhitë vazhdonin të kullotnin, Murrin i hyri midis këmbëve, luante bishtin dhe tundte kokën.

Gjergjit i vanë sytë te dhia që kishte mbebur pa kec. Ajo nuk përtypej. Nuk kishte qejf të kullotte. Avitej nga kecat e tjerë, u merrte erë dhe i shtynte lehtë me brirë.

Gjergji e ndolli. Dhia u afrua. Djaloshi e përkëdheli në qafë dhe i foli në vesh:

— Durim, Bardhoke. Na i grabitën. Po në

fyt do t'u mbetet. Ja, ndodh edhe kështu, të shkojë keci para dhisë...

Edhe Murrua sikur ndjeu një boshllëk. Vარი veshët. Dukej se merrte pjesë në atë hidhërim. Gjergji e lëmoi:

— Eh, Murro. S'ke ç'bën. I ligu është mësuar të rrëmbejë. Harroje dhe ti laramanin... tani, o burra, çaj rrugën se kemi punë.

Murrua tundi kokën, sikur t'i kishte kuptuar të gjitha. Lehu disa herë dhe mori monopatin dredha-dredha, monopatin që të nxirrte buzë pyllit mbi fshatin malor.

Qielli kishte filluar të skuqej. Dielli rrëshqiste për në perëndim. Retë lëviznin në drejtim të veriut. Nga pylli po vërshonte një napë e përhimtë sikur donte të përpinte luginën.

Poshtë kodrës, në rrugën kryesore, ecte një plakë duke tërhequr prej kapistre lopën. Plaka ecte dhe tirtë. Prapa, një nuse ngarkuar me dru. Përtej mullirit, një vajzë e vogël kishte vënë përpara një tufë dhisë.

Te kthesa e rrugës Gjergji u takua me vajzën. Bagëtia u përzien. Vajza, si e kundroi në fytyrë Gjergjin, i tha:

— Gjergj, dukesh shumë i lodhur.

— Besa po. Gjithë ditën kam rendur për të gjetur kecin laraman. Përsëri do të shkoj në

pyll ta kërkoj. Shpjeri po deshe dhinë e mia në shtëpi.

Vajza pranoi. Gjergji u vu në rrugën nga kishte ardhur.

Baresha e vogël e ndoqi me shikim ledhatonjës dhe i thirri:

— Mos hyrë thellë në pyll, Gjergj, pylli ka ujçër dhe njerëz të këqinj... Nata është qorre... Nuk të le të shohësh...

Gjergji, në pikë të vrapit, i tundi dorën.

...Në dritaren e zyrës së Vullnetit kishte dritë. Gjergji ju avit ndërtesës me hap të shpejtë. Zemra i gufonte dhe në këto çaste e ndjente veten krejtësisht të lehtësuar. Po pa hedhur as pesë hapa, u ndal papritur në vend. Gjithshka ju duk se u përmbys. Pa se te gardhi, puç me ndërtesën e seksionit, ishte lidhur kali i Selimit. Hodhi një vështrim të shpejtë përreth dhe u tërhoq në drejtim të murit të shkollës.

«Po kjo ç'të jetë?.. Ç'do Selimi këtu?..»

Kaloi murin dhe hyri në kopshtin e shkollës dhe zuri vend atje, ku dukej hyrja e ndërtesës së seksionit.

Në ato çaste pritjeje, Gjergji ndjente se durimi po e linte. E pushtoi dëshira që të takohet sa më parë me Vullnetin dhe t'ja numëronte të gjitha. Minutat po i dukeshin orë. «Po



Selimi ç'po i thoshte Vullnetit? Kishte shkuar atje për të mirë, apo për të keq?...»

I vinte inat që Vullneti po ja zgjatte aq shumë atij, Selimit, i cili kishte biseduar gjithë ato gjëra me diversantët.

Ndërsa ziente në mendimet e tij, te praku i derës pa dy hije. Pas pak dy trupa. Dy burra u përshëndetën dhe u ndanë.

Sakaq, Gjergji, si një ketër, kërceu në rruge dhe si vetëtimë u lëshua drejt Vullnetit.

Vullneti ktheu kokën dhe pa me habi Gjergjin e vogël që mezi merrte frymë. E qortoi:

— Pse kaq vonë?.. Sa herë të kam këshilluar të mos dalësh jashtë shtëpisë natën. Pse nuk na dëgjon? Po nëna a e di se ku je?

Gjergji uli kokën. Vullneti s'po i reshtte qortimet. Kur ai mbaroi, djaloshi i hodhi një vështrim qortues, kuptimplotë, që e bëri bashkëfolësin të mendohej për tonin e tij pak të ashpër. Ai kundroi fytyrën e Gjergjit e diç lexoi në sytë e tij të zjarrtë.

— Folë, Gjergji! — i tha me zërin e tij të zakonshëm.

— Ç'të flas. Ju s'më latë të hap gojën.

Vullneti qeshi me të madhe dhe e kapi Gjergjin për qafe. Hynë të dy në zyrë.

Vullneti buzëqeshi e tha:

— Urdhëro, shoku qytetar, na trego pse jini lodhur!..

Gjergji çuditej sa shtruar i merrte punët Vullneti. Pa i matur fjalët tha:

— Ti më prite me këmbët e para... Nejse...
Ti nuk di pse jam lodhur.

Vullneti e pa me vëmendje.

Gjergji vazhdoi:

— Unë erdha këtu në këtë orë që të di pse është lodhur Selimi... Dua të di: është burrë i mirë ky njeri, apo i keq?..

Vullneti rrudhosi ballin dhe përqëndroi shikimin në fytyrën e Gjergjit të bërë prush.

Gjergji shtoi:

— Mos më shiko ashtu. Më thuaj, pse ishte Selimi këtu. Mos u habit. As mos hesht. Koha nuk pret. Unë të them të vërtetën...

Vullneti rrudhosi ballin dhe tha me ngadalë:

«Dreq... Ç'është kjo e papritur...» Po nuk e bëri veten.

Vullneti qeshi.

— E mirë, kallëzomë pse ke ardhur.

Gjergji nuk u përmbajt më. I tregoi fill e për pe të gjitha ngjarjet e ditës.

Vullneti futi gishtërinjtë midis flokëve. Ho-dhi vështrimin përdhe. Vrau mëndjen një copë herë, pastaj tha:

— Dhe Mëhilli duhet të shkojë te Përroi i Ujikut?..

— Kështu më thanë.

Vullneti përsëri pyeti:

— Pa m'i thuaj dhe një herë ato fjalët e shkëputura që dëgjove?

— Kurti i tha Selimit: mos u ngut... Prej këtej do të shkosh... Njerëz të armatosur... Përroi i Ujikut... Kupton?..

Vullneti ngriti kokën dhe tha prerë:

— Çdo gjë e qartë. Ti ke të drejtë për Selimin... Të lumtë, Gjergj, na ndihmove të zgjidhim një lëmsh të ngatërruar...

Zilja e telefonit ra gjatë. Vullneti me dikë bisedoi. Dha urdhëra.

Pa vonesë thirri dy oficerë dhe i nisi diku... Pastaj mori përsëri telefonin dhe vuri një tjetër në dijeni për të gjithë ngjarjen...

Nuk kaloi asnjë orë. Shumë çështje u sqaruan. U sqaruan dhe shumë fije të dyshimta që vërtetonin plotësisht qëllimin e diversantëve.

Ndërtesën e seksionit e pushtoi gjallëria. **Atje erdhën shumë njerëz. Ata u vunë në lëvizje.**

Në zyrën e Vullnetit hyri një meso burrë me trup të fortë si çeliku dhe të derdhur si lisi. Ky diçka foli me Vullnetin. Ai i tha:

— Shoku Besnik, djemtë tanë janë të zgjuar dhe guximtarë.

Besniku u kthye nga Gjergji. E pushtoi dhe e puthi në të dy faqet.

— Të lumtë, djalosh! Sonte ne mësuam shumë prej teje.

Dhe, sa tha këto, pyeti Vullnetin:

— Nga duhet t'ja fillojmë?

— Masat e para i muarëm. Vendi është rrethuar... të gjitha shtigjet u zunë. Prita janë ngritur kudo. Disa grupe kërkimi të maskuara janë shpërndarë në pyll.

Besniku u përkul mbi një hartë të hapur në tavolinë dhe, si mbërtheu shikimin mbi disa radhë të shënuara me kalem të kuq, pyeti me zë të ulët e të shtruar:

— Si mendoni ju, shoku Vullnet, a nuk do të ishte mirë që ne të shkonim dhe të zinin vend pikërisht te Praku i Erës? Tre të tjerë të shkojnë në afërsi të Shpellës së Minjve, ku, sipas lajmeve që kemi marrë, kanë zënë vend diversantët... Pastaj nuk do të bëjmë keq të lëmë dhe një grup rezervë për të mbuluar çdo kalim të paparashikuar prej nesh...

Vullneti, pasi u mendua, pranoi.

Besniku u ngrit nga tryeza. Në dhomë kishin hyrë dhe disa burra të tjerë.

— Dëgjoni, shokë. Unë dhe shoku Vullnet me tre ushtarë dhe dy fshatarë të armatosur do të shkojmë te Praku i Erës...

Kërciti karriga. Besniku ktheu kokën. Gjergji qëndronte më këmbë. Besniku buzëqeshi.

— Të vij dhe unë, shoku Besnik, rrugën e di aq mirë sa mund t'ju çoj në atë vend, më mirë se ditën.

— Gjergj, mos u mërzit, ti e kreve detyrën tënde. Tani na lerë ne ta shpiem deri në fund...

Besniku u drejtua nga shokët:

— Kështu pra, të nisemi. Operacioni duhet të fillojë.

Jashtë u dëgjua frenimi i një maqine.

Era e ftohtë u rrihte fytyrat e ndezura. Nata ishte e qëruar dhe hëna zbardhte si ditën. Grupi me në krye Besnikun po i afrohej në heshtje Prakut të Erës...

Gjergji me zemrën plagë, që nuk mori pjesë në operacion, nuk mbylli sy gjithë natën. Mendonte përfundimin e operacionit...

Mëngjezi zbërtheu me hare. Dielli vetëtiu si asnjëherë tjetër. Në veshët e Gjergjit gjëmoi e fuqishme kënga e ushtarëve të batalionit territorial të ndjekjes. Ata po ktheheshin fitimtarë...

Besniku erdhi pak më vonë. Krah tij ishte nëna e Gjergjit. Ai ishte rrethuar nga fshatarët

e armatosur. Të gjithëve u qeshte fytyra. Të gjithë ishin të gëzuar dhe të lumtur.

Gjergji i shikonte dhe kërkonte sa më parë të dinte fundin e operacionit.

Besniku e pa atë dhe e thirri. Të gjithë mbërthyen vështrimin te Gjergji i vogël. Nëna e tij mbushi sytë me lot.

Gjergji, kokëulur, qëndroi para Besnikut. Ky e pushtoi me krahët e tij të fuqishëm dhe e puthi në ballë.

Besniku duke ju drejtuar të gjithëve tha:

— Ja, shokë, ky është Gjergji ynë, Gjergji i zgjuar dhe trim.

Gjyshja Marë e ndërpreu fjalën dhe hodhi vështrimin te zjarri.

— Teuta, sill gështenjat t'i pjekim!

Asnjë nga fëmijët nuk u ndie. Ata qëndronin të heshtur dhe prisnin vazhdimin e tregimit. Kaloi një kohë kështu.

Miri pyeti në heshtje:

— Na trego, nënë, ç'u bë më tej. Me Selimin dhe Don Françeskun, që ndihmonin diversantët ç'ndodhi?

— Ata, mor bir, i arrestuan menjëherë. Pastaj kuptohet, morën dënimin e merituar. Në vend të Don Françeskut në fshat erdhi një

prift i ri që quhej Don Pavël. Ai ishte më dhel-
për se i pari.

— Po Gjergji ç'u bë? — u hodh Gimi.

Gjyshja Marë ngriti shaminë e zezë që i kishte rënë mbi ballin plot rrudha, psherëtiu thellë dhe u mbush me frymë. Ajo u duk sikur mori jetë, sikur u përtërit.


— Këtë radhë unë ju tregova vetëm një histori: zgjuarësinë dhe guximin e Gjergjit tonë. Kur të bjerë dëbora e parë do t'ju tregoj dhe më për veprat e këtij djali...

Jashtë errësira kishte mbuluar gjithshka. Dëbora e butë binte ngadalë me flokë të mëdha dhe e trashte shtresën e bardhë mbi tokën e ngrirë.

Në dhomën e vogël e të ngrohtë, ku llamba elektrike ndriçonte plot shkëlqim, fëmijët e vegjël ja kishin ngulur sytë buzëvet të gjyshes Marë dhe prisnin me padurim që ajo t'u tregonte ngjarjen e premtuar.

Gjyshja Marë puliti sytë, ndenji një copë herë duke u menduar, si për të mbledhur kujtimet, pastaj me atë zërin e saj të ëmbël, ja nisi rrëfimit...

...Kaluan dy vjet nga koha e ngjarjes që ju kam treguar më parë. Gjergji i vogël, ai



Gjergj që bridhte dikur përmes pyllit duke kullotur tufën e dhive, u rrit. Atë vit kur në fshatin tonë do të ndërtohej rruga e re, Gjergji mbushte të gjashtëmbëdhjetat.

Një ditë, mori vesh se pas hapjes së rrugës, në pyll do të fillonte ndërtimi i minierës. Atë here filloi t'i digjej zemra nga dëshira për të punuar në minierë. Pas disa muajsh Gjergji nisi të punonte në ndërtimin e rrugës. Ai u bë shpejt një punëtor i mirë. Më vonë puna e tregoi se mund të bëhej dhe një minator me vlerë.

Po nuk ishte e lehtë të çaje në rrugën e re që kishte nisur Gjergji. Në fshat filluan të përhapen fjalë: «Gjergji u marros. Me kokën që ka do ta pësojë... Mbani mend po nuk u bë copë e çikë në mes të shkëmbinjve...»

Djaloshi nuk çante kokën për këto pëshpëritje, që nuk dihej nga dilnin. Ishte i sigurtë se ata që përhapnin fjalë të tilla nuk ishin njerëz të mirë.

Një natë Gjergji u vonua në punë. Ai nuk e kishte zakon të vonohej mbrëmjeve, prandaj e ëma filloi të shqetësohej.

«Mos i ka ndodhur gjë?» mendoi ajo duke u dredhur si një fëmijë. Përpara syve i shfaqeshin hije të tmerrshme. Doli te gardhi. Në këtë kohë vuri re Gjergjin që po vinte në shtëpi duke vërshëlyer. Djali u çudit, kur, nën dritën

e kandilit të oborrit, pa fytyrën e Lokes të çakërdisur.

— Ç'ke kështu, nënë, pse je shqetësuar?

Lokja u shkreh në lot. I tregoi djalit frikën që e kishte kapur.

— Shumë flitet, mor bir, se puna në pyll është e rëndë dhe e kotë. Veç gurëve, atje s'ka asgjë tjetër. Dhe në rast se ka ndonjë madem, ku dimë ne ta nxjerrim. Se mos kemi maqina... Ne vetëm dhinë na kanë mbajtur gjallë deri më sot.

Gjergji nuk i mori me shaka këto fjalë. Disa herë Lokja e tij i kishte folur shkarazi fjalë të tilla që qarkullonin gojë më gojë. Edhe vetë kishte vënë re se disa njerëz, përpara thirrjeve për të punuar në minierë, qëndronin të ngurosur.

Mendoi shumë për këtë djali. Prapa këtyre fjalëve fshihej një armik i padukshëm. Hije që vërtiteshin dhe villnin vrer.

Po kush ishin këta?

Rruga e re çahej dhe shtrohej pëllëmbë pas pëllëmbë. E drejtë dhe drethka-drethka kalonte qafave të thepisura, brinjëve thikë dhe çante poshtë e lart mes shkëmbinjve dhe shpellave.

Ndërtimi i rrugës ishte fillimi i punës së madhe.

Një ditë, papritur shpërtheu një krismë e fortë, tamam si një gjëmim që e bën duman anembanë vendin. Pas saj u dëgjua një uturimë e çjerrë. Njerëzit që kishin mbetur në fshat menduan dhe thanë:

— Vetëm i madhi zot mund të lëshojë një uturimë të tillë.

Vrapuam me të katra, me kuç e me mace e u mblodhën te Hurdha e Kecit. Vështrimin e mbërthyem te Qafa e Ylberit. Pamë maqina, vetëm maqina, që vinin varg njëra pas tjetrës. Nga larg ato dukeshin si një zinxhir me nyje të mëdha.

Pleqtë shikonin me habi dhe fërkonin sytë. Fëmija hidheshin pupthi, ashtu si zogu para një kothere buke në piskun e dimrit. Papritur aty u dha Gjergji me një grup të rinjsh. Zëri i tij e theu habinë:

— Praku i Erës u hodh në hava. Ja, shikoni karvanin e lumturisë... Tani erdhi koha t'i shkullim zemrën malit, t'i presim hovin lumit.

Të gjithë i kishin ngulur sytë djaloshit kur fliste me fytyrën flakë nga gëzimi. E shihnin dhe fërkonin sytë. Vërtet do të mund ta mposhtnin malin dhe t'i vinin fre lumit?

Gjergji. në mes të grumbullit të të rinjëve,

dalloi nga larg Canin. Për atë të gjithë nuk flisnin mirë dhe e shihnin me urrejtje. Familja e tij kishte qenë ndër të pasurat e krahinës dhe kishte pasur lidhje me bajraktarin. Cani ndodhej midis një grumbulli fshatarësh dhe se ç'po u fliste me zë të ulët. Me marifet djali u afrua dhe ngriti veshët të dëgjonte.

— Nuk po e ndjeni si po tundet toka?.. Nuk shikoni se erdhi fundi? — dëgjohej zëri i Canit. — Po e prekëm malin, do të na dënojë zoti. Pylli do të thahet, uji do të shterojë. Atëherë bagëtia nuk do të ketë vend ku të kullosë. Nuk bëhen këto gjëra, o njerëz, fët e fët, si mendojnë këta të rinjtë. Ehu, duhen vite, shekuj...

Gjergjit filloi t'i mbushej mendja top për Canin:

«Ky qenka nga ata që vjellkan vrer» — tha me vete. Me rrëmbim u fut midis grumbullit dhe ju drejtua atij që fliste:

— Pusho, gjarpër. E dinë të gjithë se gëneshtra ka zënë rrënjë në zemrën tënde. Mos u mundo kot të mbjellësh panik, frikë dhe mosbesim. Ne e njohim fuqinë tonë.

Fshatarët sikur u gjallëruan nga fjalët e Gjergjit, ndërsa Cani e pa se djaloshi ja kishte zbuluar gjurmët. Për të shpëtuar nga fjalët e tij, ju drejtua përsëri me një buzëqeshje dhel-përake fshatarëve:



— E shihni ç'djalë budalla është? Më vjen keq për të, se të atin e kam pasur mik të ngushtë.

— Mos u lodh kot, o Can. Ti tashmë je bërë i njohur. Po ta them në sy të fshatit, nuk je gjë tjetër veçse tymi i një zjarri të shuar.

Canit rrudhosi vetullat e ashpra dhe të gjata, pastaj vërshoi mbi Gjergjin:

— I poshtër, ta tregoj unë. Kë fyen sy fshatit...

Zëri i Canit të kallte datën.

Gjergji, i shkathët, i shpëtoi shkopit që ngriti Cani. Kërceu mbi një shkëmb që ndodhej buzë rrugës.

Fytyra e Canit u zbeh. Goditi gjoksin me grusht.

— Do të të padis... Ka ligje sot...

Me të thënë këto, u vërsul përsëri si bishë mbi Gjergjin. Do të ishin kacafytur keq, por menjëherë dy të rinj dhe një burrë ndërhyjnë dhe me zor të madh i ndanë.

Canit qëndroi një çast në heshtje, aq sa u mbush me frymë. Filloi përsëri të fliste dhe të kërcënonte Gjergjin.

Po djali i doli përpara:

— Ç'ke që ulurin?.. Kush ta ka frikën!..

Canit ngriti grushtin. Po grushti ra mbi shpatullën e Krosit që posa kishte arritur aty dhe kishte ndërhyrë t'i ndante. Krosi hiqej si-

kur nuk e donte këtë grindje po, në të vërtetë, i bëhej qejfi që Cani kërkonte ta rrihte Gjergjin.

— Mos, Can, mos bre burrë... Pse rri e mesh me një femijë? Nuk e sheh se i ka ende buzët me qumësht? Lëre në punën e tij, të flasë ç'të dojë.

— Më le, o Kros ta bëj fërtele, maskaranë. Sa të jem gjallë s'do ta harroj këtë turp...

— Gjepura — tha dikush midis fshatarëve, — ti je mishërimi i turpit.

Të rinjtë e shihnin Canin me urrejtje.

— Kështu i duhej çjerrë maska këtij maskarai. Gjergji ka të drejtë — thirrën disa nga grumbulli i të rinjëve.

Cani, i vrenjtur si një mot i keq, duke fshirë gjakun që i kullonte nga hundët, shpërtheu si një rrufe:

— Flisni, o burra!

U dëgjuan disa pëshpëritje. Cani e dinte se midis fshatarëve kishte ende të atillë, që ja kishin frikën dhe e respektonin si burrë zakoni.

Një fshatar kërkoi të fliste. Vështrimet e të gjithëve u derdhën mbi një burrë të shkur-tër, me fytyrë të buhavitur, me hundë të madhe dhe me sy të përhimtë.

— Mos ta marrim rrëmbyer — foli fshatari që quhej Çup, — Cani ka të drejtë. S'ka burrë t'i pranohë ato fjalë që i tha Gjergji.

Hyri në valle edhe Don Pavli:

— Turp, mbylleni këtë histori. E po e thotë ndonjë fjalë njeriu. Po nuk është parë që i vogli të ngrihet kundër të madhit. Këtë nuk e thotë as kanuni.

Disa filluan të lëkundeshin. Mbajtën anën e Canit. Gjergjin filluan ta qortonin.

Duke marrë zemër, Cani e ktheu fletën:

— S'kam nevojë për mbrojtës... Do ta padit...

Gjergji u zemërua më tepër me priftin. Urata në të vërtetë donte t'i hidhte benzinë zjarrit.

— Po ju ku doni të dilni me këto fjalë, Don Pavli?

Prifti e kuptoi se stuhia ishte gati në shpërthim. Duke i dhënë fytyrës një pamje të përvuajtur, tha me një frymë:

— Fola një herë. Mos t'i marrin punët rrëmbyer. Mos të grindemi kot me fjalë e me grushte. Kështu na porosit zoti. Paqë e përgjithshme dhe e përjetshme.

— Ti, o prift, e di mirë rëndësinë e fjalës. Fjala sjell veprën. Na thuaj, ç'bën ti në kishë. Nuk do të tregosh. Atëherë shkurto gjuhën.

Don Pavli uli shikimin dhe ngriti duart drejt qiellit. Dukej sikur donte të lajmëronte zotin për ato që po ndodhnin aty. Dhelpër ishte.

Çdo gjë muntohej ta shuante me lutje dhe përgjërime për «paqë» që ja drejtonte qiellit të hapur.

Kështu ndodhi atë ditë, fëmijë të dashur. Cani mori të shoqen, një grua kockë e lëkurë, që mezi mbahej në këmbë dhe u zvarrit si një krimb i lagur drejt shtëpisë së tij. Edhe Don Pavli u largua, ashtu i përvuajtur si dukej, në drejtim të kishës. Çupi dhe Krosi rrinin më dysh të mërzitur. Gjoja u vinte keq për atë që ndodhi.

Sidoqoftë fshatarëve atë ditë ju hapën sytë për shumë gjëra. Filluan të mendonin ndryshe dhe t'i shihnin me sy tjetër ata njerëz, që flisnin kundër punës që po bëhej në fshatin tonë. Grushti i Gjergjit kishte qëlluar atje ku duhej.

Gjyshja Marë e ndali pak rrëfimin, si për t'u çlodhur, u hodhi një vështrim të ëmbël fëmijëve, mblodhi këmbët dhe pastaj vazhdoi:

— Mos u mërzitni, fëmijët e mi. Fjalët e të ligut janë të hidhura, të hidhura më keq se pelini dhe se vreri. Vepra e tij është e egër, si vdekja.

Sytë e gjyshes Marë shkëlqyen në fytyrën e rrudhosur. Ajo hodhi në vatër edhe disa dru.

Fëmijët ndoqën me kureshtje lëvizjet e gjyshes Marë. Teuta e shkathët pa u vënë re i pregatiti kafënë dhe ja vuri përpara.

Gjyshja Marë e thithte lëngun qetësisht dhe mendonte. Kur e mbaroi dhe fshiu buzët me shami, zëri i saj tingëlloi...

...Kishte ditë që binte dëborë. Ja, kështu si sot. Era çirrej. Të dukej se gjithshka ishte varrosur nga mbulesa e bardhë...

Miniera kishte disa muaj që e kishte prishur qetësinë shekullore me zhurmën e saj.

Njerëzit e vazhdonin punën. Pastronin grykat e galerive, sheshonin pirgjet, që kishin blouar rrugët, drejtonin maqinat...

Po, papritur, fryu veriu edhe më fort, dimri, si për inat, u dynd si një armik i tërbuar. Tufanet u bënë më të fuqishme, më shkatërruese.

Të dukej sikur dimri do të zhdukte nga faqja e dheut çdo gjë, që të jetonte i vetëm dhe i qetë në këtë krahinë të shumëvojtur...

Njerëzit e punës nuk u thyen. Nuk u tërhoqën. I vunë gjoksin së keqes. Vazhdonin me guxim të gërryenin zemrën e malit, të hapnin rrugët e blouara. Ndërtonin godina dhe hapnin tokë të re...

Të dukej se kallkani shkrihej para afshit të punës.

Cani nuk mbylli sy deri në mëngjez. Në qetësinë e natës koka i digjej zjarr. Brenda në trup ndjehej sikur i vlonte serë e ndezur. Ai vuante. Kishte humbur durimin. Shpresat që ai ushqente, se dimri dhe tufanet do të bënin të tyren, nuk po dukeshin kurrkund. Puna e filluar në pyll po ecte mbarë.

U ngrit i nevrikosur, rrëmbeu opingat, setrën, u vesh shpejt e shpejt dhe doli.

I ra fshatit rreth e rrotull deri sa u lodh. Zemra ju bë copë. Sytë ju errësuan. Po nuk e lëshoi veten. Shikonte njerëzit që ktheheshin nga pylli dhe ndihmonin kooperativën.

«Ej, drej, në kohën tonë s'lozte njeri nga vatra. Burri pinte raki. Gruaja bënte drekë e darkë. Fëmijët çanin dru».

Dhe, duke zier në mendimet e tij, u drejtua nga kisha.

Don Pavli e pa nga larg dhe i doli për ta pritur në shkallët e qelës.

— Dukesh i lodhur, o Can, — belbëzoi prifti, — tani të kisha ndër mend. Do të vinja sonete në shtëpi.

— U lodha, don Pavl, — foli Cani, — por

mos pandeh se pleqëria më ka marrë forcat...

Don Pavli i ra shpatullave me dashamirësi.
Cani vazhdoi:

— Tani më të rrallë po takohemi dhe ju bëheni të gjallë vetëm kur dëgjoni hapat e mi dhe kur na dërgojnë ndonjë lajm miqtë tanë...

— Kështu kemi vendosur...

— E di, e di se kështu kemi vendosur, po duhet të dish se unë jam kryetari yt, ashtu si Krishti që është kryetari i besimtarëve. Kryetari kërkon lajme. Pret të japë urdhëra...

— Kush e mohon këtë, o Can. Ty të kemi kryetar. Prisja lajmet dhe mbrëmë mbërritën...

— Mbërritën!

— Këtë herë erdhën nga një rrugë tjetër, jo nga mali, po nga qyteti. Duhet të fillojmë. Ashtu mendojnë dhe kryetarët tanë jashtë shtetit. Kërkojnë të përmbysim dhe të groposim minierën...

Ky mendim i pëlqeu Canit.

— Kështu pra, je dakord t'ja fillojmë?

— Urdhëri i kryetarit, urdhëri i zotit.

— Lajmëro atë të minierës. Bëji zë atij të fshatit që të vijnë nesër mbrëma nga shtëpia ime. Më kupton?..

Don Pavli tundi kokën në shenjë pohimi.

Pas largimit të Canit, ai nuk ndjeu asgjë,

veç të ftohtit. Mblodhi forcat dhe u nis për të lajmëruar miqtë e tij...

Kaloi edhe një ditë. Erdhi mbrëmja, e ftohtë dhe e murme.

Canit, pranë oxhakut, i mbante sytë hapur dhe veshët ngritur. Priste nga çasti në çast të dëgjonte zërin e së shoqes. U çua. Shkoi te dritarja. Vërejti. Jashtë nuk dukej gjë, veç dëborës që vezullonte. Tha: «dreqi ta hajë. Pse u vonuan?»

Canit u afrua disa herë me radhë te dritarja, nga dukej shtegu prej të cilit do të vinte miku i tij, po syri nuk i kapi asnjë njollë të zezë...

U ul te vatra dhe hodhi mbi zjarr disa shkarpa. U çua përsëri dhe shkoi hapi pak derën. Gruaja e tij ishte zgjuar dhe rrinte në vrojtim.

— E, duket gjë?

— Dy njolla të zeza.

— Mos luaj nga vendi dhe pasi të hyjnë në shtëpi. Kontrolllo çdo gjë...

Pas disa minutave para Canit qëndruan dy burra.

Canit i priti rëndë. I vështroi turbull sikur të mos i kishte parë asnjëherë tjetër.

— Ç'të shtyri të na thërresësh në këtë kohë të tillë? — pyetën të porsaardhurit.

Cani i vështroi edhe një herë si nëpër mjergull.

— Urdhëri... Na pret një punë e rëndë.

Çupi, kur dëgjoi këtë, ndjeu se dyshemeja u përmbys.

— Do të përpiqemi... të punojmë — tha Krosi me të prerë.

Canit nuk i pëlqeu kjo shprehje e thatë. U ngrit nga vendi, pa thënë asnjë fjalë.

— Ku i latë përbetimet...

Krosi vazhdoi me të njejtin ton:

— Nuk kemi harruar asnjë përbatim. Çdo ditë kemi pritur fjalën tënde... Në pritje dhe, duke parë ato që po ndodhin rreth nesh, na është dukur se çështja jonë u varros.

Cani e kuptoi se Çupi dhe Krosi ishin shumë të dëshpëruar. E goditi fort në sup Çupin.

— Mos e humb, Çup. Ende nuk është varrosur. Dita jonë do të vijë. Mbahu i fortë dhe puno me zemër të ngrohtë... se këta s'e kanë të gjatë.

Pas këtyre fjalëve ranë në heshtje dhe vetëm herë pas here shkëmbenin vështrimet si për të kuptuar më mirë njeri-tjetrin.

Çupi pyeti si me ndrojtje:

— Keni marrë ndonjë lajm të ri?

Cani qeshi nën buzë.

— A do të vijë dita jonë? — pyeti Krosi.
— Kur dëgjoj të flitet në fshat, se dita jonë do të vijë kur të pjellë mushka, dhe kur të bëjë këndezi vezë, zemra më copëtohet.

Cani shtrembëroi fytyrën dhe kërciti dhëmbët.

— Pikërisht, për këtë ju thirra. Urdhërin e morëm, duhet të fillojmë vetë. Ti, Kros, do ta kesh pak të vështirë punën në minierë.

— Të vëmë dorë!..

— Të përmbysset. Ata që të mbeten gjallë të lebetiten që as emrin mos t'ja zënë në gojë minierës...

Çupi u pre. Fytyra i ngriu. Psherëtiu:

— Mjerë unë i ziu...

Gruaja e Canit hyri me tepsinë me meze.

Çupi, duke parë vendosmërinë e Canit dhe të shokut të tij, u kthjellua. Hoqi qylafin nga koka dhe fërkoj ballin e dërsitur.

Biseduan tri orë të mira me zë të ulët, kokë më kokë, duke rrëkëllyer gotat e rakisë. Mbetën dakord që mos të takoheshin më bashkë; të shanin njeri-tjetrin sy fshatit. Çupi urdhërat që do t'i merrte nga Don Pavli do t'ja transmetonte Krosit.

Si u largua Çupi me Krosin, Cani qëndroi para dritares. I lëvriu një buzëqeshje cinike:

— Të gjithë ata, që ndodhen në rrjetën time, nuk do ta kenë lehtë të largohen. Të gjithë do t'i hedh në veprim dhe do t'i ngatërroj keq e më keq me këtë qeveri...

Brigadieri Bardhi mbërriti fluturimthi. Te hyrja e galerisë hodhi krahëve mushamanë dhe u zhduk në thellësinë e malit. Si eci disa metra, dikush thirri:

— Bardhi...

Ishte Gjergji, që me zor po çante llucën e galerisë. Duke ngritur duart e ngarkuara me baltë, i tha shokut:

— Përsëri shembje e armaturës...

Tutje, nga thellësia e malit erdhi një zhurmë e mbytur dhe u ndien lëkundje, sikur të frynte një erë e marrë.

Bardhi pyeti:

— Ka dëmtime në njerëz?

— Pesëmbëdhjetë punëtorë kanë mbetur te galeria kryesore.

Sytë e Gjergjit shkëlqyen nga lotët.

Bardhi uli kokën dhe çau përpara.

Nga vendi i shembur rridhte rrëke uji. Herë pas here shkëputeshin copëra dheu dhe gurë. E vërejtji mirë e mirë atë plagë.

— Ç'duhet bërë tani?..

Asnjë nuk foli.

— Mund të përcaktojme gjatësinë e she-
mbjes?

Punëtori, që ndodhej përballë tij, tha:

— Ja, e përcaktuam, po do të bëjmë atë
që duhet në kohën e duhur...

Bardhi u mendua për një hop.

— Ç'mendim keni ju?

— E kam vështirë të flas...

— E kontrolluat armaturën?

Punëtori u përgjegj me dëshpërim:

— Lënda është e fortë, po puna është bë-
rë e dobët.


Bardhit i vetëtinë sytë dhe u kthye nga
Gjergji.

Uli kokën. Mendonte. Mendonte për shka-
kun e shembjes. Si mund ta gjente tani rrugën
e shpëtimit të shokëve, që ishin blouar? Bar-
dhi ishte i matur dhe i peshonte mirë gjërat.
I dëgjonte të tjerët. Deshi t'u jepte zemër atyre
që rrinin si të tulatur.

— Avaria ndodhi. Ç'thoni, nga duhet t'ja
fillojmë?

Heshtje.

Bardhi eci përpara. Nuk qe e lehtë. Pesë-
mbëdhjetë burra të blouar. Ai e dinte se çdo
minutë vonese ishte vdekje për ta. Si njeri i
vendimeve të shpejta, hyri në mes të llucës...



Gjergji vijoi pas tij dhe duke mbajtur lart llambën e karbitit.

Bardhi ishte aq i zhytur në mendime, sa të linte përshtypjen sikur do të përpinte të gjithë masivin e dheut, që kishte zënë hyrjen e galerisë. Ai mendonte dhe llogaritte, dukej sikur numëronte sa gurë dhe sa lopata dheu përmbante në vetëvete masivi që kishte përpara. Vërejtja dhe disa pjesë të armaturës duke murmuritur në heshtje:

— Keni të drejtë. Krahu i djathtë është lidhur dobët. Nuk janë respektuar kërkesat teknike... Mungesë kontrolli... Filloni: vendosni dy motopompa dhe nxirrni ujin jashtë... Filloni përforcimet e armaturës.

Gjergji ja priti:

— Shoku Bardh, kam një mendim.

Bardhi i hodhi një shikim dashamirës dhe e nxiti:

— Folë.

— Të mundohemi dhe për pastrimin e pjesshëm të galerisë, të bëjmë kërkime për gjetjen e fillit të ajrimit.

Bardhi e dëgjoi, por nuk shfaqti mendim. Pyeti papritur:

— Po tekniku ku na u zhduk?

Krosi theksoi me urrejtje:

— Lëre dreqin, ç'e do!

Një punëtor shtoi:

— Doli jashtë galerisë.

— Bëjini zë të vijë.

Tekniku erdhi me të katra. Pas tij ecte dhe inxhinieri i shoqëruar nga dy specialistë të tjerë.

Bardhi u përshëndet me të porsaardhurit dhe i hodhi teknikut një vështrim të ftohtë:

— Lënda nuk ka asnjë faj...

Tekniku, si për çudinë e të gjithëve, nuk nxori zë.

Krosi, ndryshe nga ditët e tjera, vërente dhe fliste rrallë. Duke parë qëndrimin e teknikut, mallëkoi nën buzë punën e bërë dhe ngri-ti zërin:

— Koha nuk na pret. Jep urdhër... Shokët po na vdesin...

Tekniku e pa vëngër.

— Nuk është punë për ty kjo...

Krosi u vrejti. Prishjen e fytyrës së tij nuk e vuri re njeri.

— E shihni, — tha — sa fodull është? Mendjemadhësia e tij solli avarinë... Kur punon njeriu si i marrë dhe nuk kontrollon atë që bën, ç'do të presësh?

Tekniku heshti. Rrëmbeu kazmën dhe hyri thellë vendit të shembur. Vërejti dhe një herë kamaren nga rridhte uji.

— Kjo duhet të mbyllet sa më parë.

Pastaj bëri disa gërmime kryq e tërthor. Vendosi dhe dy kunjat e tha:

— Midis këtij korridori që caktova, të kërkohej tubat e ajrimit.

Bardhi dhe Gjergji u shikuan sy ndër sy. Krosi u shtang. Inxhinieri pohoi:

— Drejt...

Tekniku vazhdoi:

— Të kërkohej tubat e ajrimit. Ndërsa nga jashtë do të fillojmë një punë tjetër... Shokët janë gjallë...

Fytyrat u çelën.

Krosi u drodh.

Gjergji pyeti me zë të ëmbël:

— Vërtet shokët janë gjallë?..

U mblodhën rreth një arke, ku inxhinieri hapi një hartë.

Vështrimet u mbërthyen mbi atë copë letër të mbushur me ngjyra të ndryshme si një ylber.

Inxhinieri filloi:

— Shokët janë gjallë... Nga galeria këtu pranë komunikuar me anë sinjalesh me shokët e blokuar.

Shpërthyen thirrje hareje: Urra! Urra! Urra!..

— Kjo kishte rëndësi — shtoi inxhinieri.
— Tani na mbetet të shpëtojmë shokët.

Të gjithë hapën sytë.

Inxhinieri nuk e prishi terezinë. Vazhdoi me zjarr:

— Deri sa dimë pikën ku janë blokuar shokët, teknikisht çeshtja e nxjerrjes së tyre në sipërfaqe është e zgjidhur.

Askush s'po kuptonte ku e kishte fjalën inxhinieri.

— Nuk po më kuptoni? — pyeti. — E shtoi: atëherë shikoni këtu, mbi hartë... E shikoni këtë vijë të zezë? Kjo vijë tregon shtrirjen e galerisë... Ky rrethi blu është pika ku kanë mbetur të blokuar shokët tanë. Këto vijat e tërthorta tregojnë gjatësinë e shembjes. Nga llogaritjet del se gjatësia e shembjes nuk i kalon të 20 metrat.

Krosi këceu:

— Po atëhere ç'presim, të fillojmë pas-trimin e galerisë.

Tekniku e pa me ironi e tha:

— Këtë vërtet e përcaktuam, po nuk duhet të harrojmë se shembjet e malit vazhdojnë dhe s'dimë sa mund të zgjatin.

Punëtorët dhe njerëz të tjerë, që ishin mbledhur aty, lëvizën dhe u dëgjuan pëshpëritje shqetësuese.

Njëri tha:

— Atëherë si do të shpëtojmë shokët?

Inxhinieri qeshi.

— Mos u mërzitni — tha duke ngritur dorën lart dhe duke treguar një kalem. — E shikon majën e kalemit? — tha. — Po fundin? Sigurisht se po. Këto dy skaje kanë lidhje në mes të tyre. Sigurisht që kanë. Në rast se i heqim grafitin kalemit, çfarë mbetet?

— Një boshllëk — tha Gjergji.

Tekniku theksoi:

— Nuk është më mirë të themi se boshllëku që mbetet është një kanal ajrimi, që lidh dy pikat?

— Qartë — pohoi Bardhi.

Inxhinieri vazhdoi të shpjegonte:

— Ne thamë se vendin ku janë blouar shokët tanë e dimë. Apo jo? Mirë. Po pika tjetër që duhet të komunikojë me të ku ndodhet?

Të gjithë ngritën supet.

Inxhinieri mblodhi hartën e parë dhe hap një hartë të dytë. Pas disa matjeve e ndali gishtin në një rreth të shënuar me kalem të kuq.

— Kjo është pika komunikuese me vendin e blokimit. Kjo pikë ndodhet mbi atë shkëmbin atje lart. Derisa arritëm të zbulojmë këtë,

na mbetet të vendosim disa sonda rreth saj, të shpojme, të hapim kanale ajrimi...

Shqetësimet u larguan. Po disa nga punëtorët nuk patën besim në këtë zbulim.

— Nga vrimat e ajrimit do t'i nxjerrim shokët?

Ironia e kësaj pyetje u duk në sy. Disa të tjerë qeshën.

Inxhinieri tha:

— Kur të kemi hapur kanalet e ajrimit dhe shokët të marrin ajrin, do të fillojmë një punë tjetër, do të hapim një oxhak dhe prej andej do t'i nxjerrim...

Zemrat gufuan. Bardhi ndjeu se u shkar-kua nga një barrë e rëndë.

Filloi puna për vendosjen e sondave. Gjer-gji dhe dy specialistët hynë në minierë për të drejtuar punimet dhe për të zbuluar shkaqet e shembjes... Brigadieri Bardhi dhe inxhinieri ecën drejt qendrës së kantierit...

Teknikut nuk i eci.

Sapo filloi turjela t'i hynte shkëmbit, u dëgjua një krismë e thatë dhe, pas kësaj, u ngrit një re tymi.

Frymët e njerëzve mbetën pezull.

Një zë çau ajrin:

— Motori u dogj...

Grupi i minatorëve dhe i gjeologëve, që po ngrinte sondat, ngeli për një çast si i ngurosur.

Krosi tha:

— Ç'përrallë e bukur! Punë kalamajsh. I duhet vënë kryq kësaj pune dhe duhet filluar pastrimi i galerisë. Shokët po na vdesin. Ne gëzohemi kot.

Tekniku nuk u zmbraps. Midis shqetësimit dhe hutimit të gjendjes thirri i vendosur:

— Puna të vazhdojë.

Krosi kafshoi buzën. Sytë ju zvogëluan. Ju afrua një burri me trup të madh dhe të fuqishëm, e goditi me bërryl në shpatull dhe, pa e vështruar në sy, i tha:

— Bëje zemrën gur. S'ke ç'të bësh. Mali të përpin...

Burri me trup të madh dhe të fuqishëm s'mori mundimin t'i fliste Krosit.

Krosi vazhdoi:

— Sa njeri i poshtër! E shikon ç'bëri?. Na i varrosi djemtë për së gjalli...

Burri me trup të madh dhe të fuqishëm ktheu kokën e pyeti:

— Për cilin e ke fjalën?..

— Për teknikun — theksoi Krosi me buzë të dredhur dhe gati t'ja shkreppte të qarit.

Burri me trup të madh dhe të fuqishëm i hodhi Krosit një vështrim përbuzës. U largua disa metra dhe foli me zë të lartë:

— Të gjallët nuk qahen. Dy djemtë e mi vërter kanë ngelur në vrimë të malit, po janë gjallë... Jam i sigurt se do t'i shpëtojmë.

Fjalët që tha ai burrë, ishin të thjeshta, po ushtuan aq fuqishëm, sa ata që i dëgjuan muarën zemër dhe forcë.

Zëri i teknikut gjëmoi:

— Forca, djema!..

U duk sikur e gjithë puna e filluar mbaroi me këtë fjalë, sikur njerëzit e bllokuan dualën në sipërfaqe dhe përqafoheshin nga shokët dhe të afërmit e tyre.

Krosi rrëmbeu karrocën dhe hyri në galeri. Në afërsi të kompresorit pa djalin e Çupit. Shpejtoi hapin. Në mendjen e tij shkrepiti një djallëzi e re: e pyeti djalin:

— Ç'bën këtu?

— Po ruaj kompresorin.

— Pse nuk mendon për Palin që ka mbetur në galeri? Pse më rri si ndonjë guak? Pse nuk i bën zë babait të vujë?

...Sondat shponin përhera dhe më shumë, shponin qetë, sikur shponin në dru dhe jo në

gur. Kanalet e ajrimit ishin gati në përfundim...

Po, për fat të keq, fjalët e lëshuara nga Krosi u rrukullisën në fshat dhe kaluan gojë më gojë. Cani u vuri sy e vetull. Kështu që, disa njerëz kokëtrashë, pa u menduar thellë, filluan të thoshin me gojën plot, se të gjitha prapësitë dhe vdekja e njerëzve në vrimën e malit erdhën nga tekniku, nga ai djalë axhami, që punonte si i marrë, vetëm e vetëm që të plotësonte planin, që të fitonte famë.

Kishin të drejtë këta njerëz kokëtrashë t'i besonin fjalët e lëshuara nga Krosi dhe të zbukuruara nga Cani.

Shembja ishte e papritur. Për një çast njerëzit u hutuan. Teknikun nuk e njihnin. Jeta e atij djali për fshatarët ishte si një libër pa krye e pa fund. Njerëzit kishin dëgjuar se ishte njëzet vjeç dhe se kishte ardhur në minierë para disa muajve vullnetarisht, ashtu si kishin bërë të gjithë shokët e tij, që me mbarimin e shkollës, zgjodhën rrugën më të vështirë për t'i shërbyer atdheut në zonat e thella dhe të prapambetura...

Askush nuk dinte më shumë në fshat. Atëhere ç'të thoshin? Kështu gënjeshttrat e të ligut gjetën vesh dhe gojë.

Çupi, sa dëgjoi blokimin e nipit, lëshoi

kujën në mes të fshatit dhe mori rrugën e minierës me ulërime dhe mallëkime për teknikun. Ecte me ngut dhe herë pas here lëshonte bre shëri fjalësh:

— Po priset bota... Na u mbytën fëmija...

Në të vërtetë Çupit nuk i vinte aq keq për nipin jetim. Bile ai kohët e fundit kishte filluar t'i pështirosej ngaqë shoqërohej me Gjergjin. Por në ato çaste ashtu e donte puna.

Arriti te vendi i shembjes. Hyri në mes të turmës. Dridhej dhe vajtonte, kur nën hundë, kur me zë të lartë.

T'i kthehet ai burri me trup të madh dhe të fuqishëm:

— Mos kaq fort, bre burrë, na i nxore mendtë...

Po donte t'ja dinte Çupi? Qante me shtatë palë lot.

Gjergji, i shoqëruar nga dy specialistët, doli nga galeria:

— Tjetër avaz ky... — Ndali një punëtor dhe i lëshoi në dorë disa metra nga tubi i ajrimit, pastaj i tha: shoqëroji këta shokët për në qendrën e kantierit.

Vetë vrapoi te vendi, ku ndodhej Çupi. E kapi nga shpatullat dhe e shkundi:

— Çup, eja në vete. Djemtë janë gjallë.
Mos qaj si ndonjë grua e keqe.

Po pushoi Çupi? U ndez më keq. Thirri:

— Gjyq teknikut. Do ta var me duart e mia...

— Ore, mblidh trutë e kokës — i tha ai burri me trup të madh dhe të fuqishëm.

Gjergji e kapi prej krahu dhe e hoqi përtej. I foli. Çupi u tulat si flaka e kashtës.

Pastaj djali i palodhur u hodh te sondat. Atje, në mes të zhurmës, që tundte dhenë dhe ajrin, i njoftoi teknikut:

— Kamarja u mbyll. Filli i ajrimit u gjend, po ajri nuk kalon. Duhet të ketë dhe këputje të tjera. Disa metra të tubit i çova në kantier.

Fytyra e teknikut u nguros. Nuk bëri zë.

Gjergji e goditi lehtë në sup dhe i foli. Tekniku dëgjonte dhe luante kokën sa lart poshtë, duke goditur me majën e këpucës një rrënjë peme.

Gjergji vrapoi poshtë shkëmbit. Në afërsi të kantierit, pa Çupin që ishte ulur mbi një gur dhe po fshinte lotët e thara. I bërtiti:

— Akoma këtu ti! Të thashë, mos mjaulit më. Pali është gjallë. Ki besim në fjalën tonë, mos beso gënjeshttrat që përhapin njerëzit e këqinj... Ik në shtëpi dhe qetësohu...

Çupi u drodh. Ju duk sikur e goditi një kopan. Uli kokën dhe u zvarrit për në fshat.

Në zyrën e Bardhit vazhdonte biseda për shoshitjen e shkaqeve të shëmbjes. Kur hyri Gjergji, një nga specialistët sqaroi:

— Është e qartë, shembja është pasojë e punës së dobët. Rregullat e kontrollit teknik nuk janë respektuar. Shtrirja e linjës së prodhimit nuk është shoqëruar me përforcimet e armaturës.

Bardhi u zhyt në mendime.

Gjergji ja dinte zakonet atij njeriu, që nuk mërzitej kurrë dhe që para se të fliste, i peshonte mirë gjërat. Shikonte Bardhin si për-typej në vetëvete, ndërsa vetë ndjehej i kënaqur për përfundimin që kishte nxjerrë rreth shëmbjes. Duke notuar i lumtur në vendimet e tij, foli me zë pak të lartë:

— Shembja është pasojë e punës së dobët të një njeriu të shkathët.

Bardhit nuk i shpëtoi kjo thënjë. Edhe të tjerët e vlerësuan.

Bardhi shtoi:

— Gjergji ka të drejtë. Çdo gjë në këtë shembje duket se është e llogaritur.

— Ç'do të thuash me këtë? — pyeti Vullneti.

— Dua të them se kllapat janë vendosur keq, me qëllim.

Ndërhyri specialisti tjetër:

— Ja, janë vendosur keq kllapat, po detyra jonë cila është?

— Të kontrollojmë punën e kryer — u përgjegj Gjergji.

— Është bërë kjo? — pyeti përsëri specialisti.

— Po si jo — theksoi inxhinieri.

— Përfundimi i këtij kontrolli: shembja — tha specialisti.

— Pavarësisht nga mungesat e kontrollit teknik — ndërhyri sekretari i partisë, — varianti i paraqitur nga Bardhi është më i besueshmi. Një dorë e stërvitur ka vepruar...

Vullneti foli mendueshëm:

— Duhet prova.

Gjergji ngriti shikimin dhe u skuq në fytyrë:

— Faktet janë bindëse.

Vullneti vuri buzën në gaz.

— Thënjet e tua mund të na çojnë atje ku duhet, ose të na çojnë në një rrugë të gabuar, në rast se faktet nuk vërtetohen...

Gjergji u skuq akoma dhe më shumë. Bardhi i erdhi në ndihmë:

— Faktet janë bindëse. Po të mos kisha formuar këtë bindje, nuk do të hapja gojën. Shkaqet e shembjes janë faktet më të gjalla... Kllapat janë vendosur keq. Veç kësaj, depozita e vajit të kompresorit është mbushur me sheqer...

Gjergji e ndërpreu:

— Edhe tubat e ajrimit janë grirë me thikë. — Doli jashtë dhe hyri duke lëshuar mbi dysheme copat e tubave të ajrimit që solli nga galeria. Dhe shtoi: — Shikoni si janë grirë?

— Po — pohoi sekretari i partisë.

Vullneti u ul dhe filloi t'i shikonte me kujdes prerjet. Si u mendua një hop, tha:

— Kjo është e tëra?

Gjergji aty për aty theksoi:

— Menjëherë, pas shembjes, u përhapën fjalë se fajtori është tekniku. Fshati zjeu dhe njerëzit u vërsulën mbi të...

Pikërisht në këtë kohë nga jashtë erdhën zëra të gëzuara. Urimet fluturonin nga çdo anë.

Bisedimet u ndërpreu. Sekretari i partisë doli i pari e pas tij shkuan dhe të tjerët.

Minatorët rrëmbyen inxhinerin dhe e ngritën hopa në krahë.

Atmosfera u mbush me urra!..

Gjergji i tha Vullnetit:

— Më duket se po e shikoj atë njeri të egër... Shembja është vepra e një njeriu.

Vullneti i la përshtypjen sikur nuk tregoi asnjë interes. Indiferent pyeti:

— Me një fjalë, ti dyshon dhe vë gisht mbi një njeri?

— Po!

Vullneti ishte mësuar ta studjonte çdo gjë deri në fund. Shumë gjëra që i tha Gjergji, për të nuk ishin të panjohura. Ai prej kohësh kishte lajme dhe kishte nxjerrë një përfundim, se jo një dorë e egër, po disa duar të egra vepronin në errësirë dhe përpiqeshin të mbillnin vdekjen e shkatërrimin. Ai përtypte dhe bluante me mendjen e tij. Sa më shumë i kristalizohej mendimi, se dikush në fshat dhe në minierë vepronte.

E dëgjoi Gjergjin me kujdes.

— Këtu paska arritur puna. Ti dyshon dhe për një njeri.

Kjo thënje ju duk Gjergjit si një fjalë e thatë, pa asnjë përmbajtje. S'mundi në ato çaste të kuptonte qëllimin e Vullnetit. Djali heshti, sikur t'i kishte dalë përpara diçka e papritur, e fuqishme, që e bëri të mbyllte gojën. Uli kokën. Mendoi t'ja fillonte nga e para, për t'u shpjeguar më qartë..

Vullneti i prishi mendimin:

— Pse hesht? Folë. Ti e fillove drejt.

Mbaroje mendimin.

Gjergji papritur tha:

— Dora e egër është Krosi.

Vullnetit i ndriti para syve një letër e vjetër. Pyeti:

— Ç'është ky Kros?

— Të kam folur një herë për të. Është ai fshatari që nuk e la Canin të grindej me mua ditën e inaugurimit të minierës.

— Ç'thonë fshatarët për të?

— Njerëzit tregojnë se, duke shitur bretkosa dhe breshka në kohën e Italisë, u bë i pasur dhe u lidh me bajraktarin...

— E pastaj!..

— Miqësia e tyre u prish. Krosi e mohoi bajraktarin. Edhe me Canin nuk ka shkuar mirë, bile para një viti janë grindur.

— Kur?

— Para një viti.

Vullneti ndjeu diçka të fshehtë në këtë histori.

— Më trego pse u grindën?

— Besa kot. Thuhet për punën e një borxi të vjetër dhe për çështjen e gardhit.

— Përse!..

— Për gardhin. Cani e paditi Krosin se i

kishte rrëzuar gardhin, ndërsa Krosi pohonte se gardhin e kishte rrëzuar era.

Mendimi i Vullnetit fluturoi lart e poshtë, pastaj u përqëndrua në një pikë.

— Dredhia e të ligut përsëritet.

Vullneti, gjatë punës së tij, kishte hasur në shumë dredhi të armikut, shumë të tjera ja kishin treguar pleqtë. Te shpjegimet e Gjergjit shikonte të njëjtën gjë. Një mister që askush nuk mund të shikonte brenda tij. Po ai pa një rrugë të njohur, ku dikur kishte ecur bajraktari.

Përsëri pyeti:

— Pse vë gisht mbi Krosin?

— Ai i përhapi fjalët për teknikun, ai nxiti djalin e Çupit të shkante në fshat; ai ishte kundërshtari për të filluar punën e hapjes së kanaleve të ajrimit; ai ka hedhur sheqerin në depozitën e kompresorit...

— Po më duket se po e shoh atë njeri të egër. Mirë, Gjergj, — përfundoi Vullneti — duhet të kesh kujdes. Mos shfaq asnjë dyshim. Fiton ai, që duron. Porosite teknikun, që të mos nxehet, të pranojë gabimet e tij.

— I fola që të mos hidhet përpjetë edhe në rast se ndonjë do ta cimbisë qëllimisht.

— Të lumtë, Gjergj. Shoku duhet ndihmuar për gjërat që nuk i di. Armiku provokon.

Të jemi të kujdesshëm, të mos biem në kurthet e armikut...

Canë kishte qëndruar para dritares dhe shikonte me kënaqësi dhe duke lëpirë buzët disa pula, që po çukisnin mbi kopicën e plehut, që ndodhej në fund të oborrit.

Ashtu si ishte, i mbytur në botën e tij, sillte ndër mend ngjarjet e fundit dhe e ndjente se punë të mëdha e prisnin...

I qepi sytë një zoge kuqaloshë dhe thirri:

— O grua!.. A e di se sot është dita e muajit dhe presim priftin për bekimin e shtëpisë dhe të gjësë?

Gruaja, që ndodhej në oborr, drejtoi trupin dhe, duke u mbështetur pas bishtit të sëpatës, u përgjegj:

— E di, o burrë! E di, se sot do të vijë prifti.

— Po kur e di, luaji një çikë ato duar. Çaj dhe disa ashkla, pastaj kape atë zogën kuqaloshë dhe këputja kokën...

Gruaja e Canit lëshoi sëpatën mbi stivën e druve dhe u turr të kapte zogën e majme.

Ndërsa ishte duke i vënë thikën në gurmaz, dëgjoi se Don Pavli kishte mbërritur dhe po përshëndetej me Canin.

— Të prisja, o njeri i bekuar. Mirë se erdhe, ulu.

— Mirë se të gjeta, o kryetari ynë.

— Dëgjoni, o miku im! Ne kemi kaluar shumë telashe bashkë, jemi mësuar aq shumë me njëri-tjetrin, sa nuk mund të durojmë gjatë pa u takuar. Meraku na gërryen.

— Ashtu është — tha Don Pavli dhe uli shikimin. — Meraku për njëri-tjetrin është i madh.

— Duhet të durojmë. Nuk do të jetë e largët dita e qetësisë sonë. Atëhere do t'i rregulloj unë llogaritë me të gjithë... Pa më trego në erdhi ndonjë lajm.

Don Pavli hodhi vështrimin rreth e qark. Cani ja priti:

— Mos u bëj budalla, s'ka njeri këtu, folë...

— Më duket se rruga jonë u shtrua... Miqtë na kanë dërguar fjalë se, pas disa ditësh, do të vijne disa njerëz të takohen me ty, Can...

— E, or mik, ju pata thënë, duroni deri në pranverë, djersa nuk na shkoi kot... Pa më trego më qartë.

— Lajmëtari mbërriti dhe më pruri letër...

Cani e ndërpreu:

— Ku e ke letrën? Ma jep.

Don Pavli shkopsiti jelekun e veladonit

dhe nxori një copë letër të mbledhur shuk. Cani, duke u dredhur nga padurimi, tha:

— Mos e hap — e ja rrëmbeu priftit. Përkuli kokën mbi letër. Mori frymë dhe ngriti shikimin lart:

— E ndjeja se do të vinte kjo kohë. E dija se një ditë do të takohesha drejt për së drejti me miqtë e mi. Tani do të çajmë përpara.

Dhe, i qetë e pa prishur terezinë, mori shishen e rakisë dhe mbushi dy gotat buzë për buzë.

— Të pimë, o miku im, për ditën tonë.

Don Pavli zgjati dorën e tij si një kërçele të mbushur me nyje dhe rrëkëlleu gotën me një frymë.

— Mbaje të ta mbush dhe një herë. Pije me fund.

— Mua më duket — filloi Don Pavli — se kemi përfituar shumë nga ndihma e miqve.

— Pa ndihmën e tyre ne nuk do të bënim asnjë hap. Ku dinim ne si prishen vrimat e hapura në mal. Për të vrarë ndonjë në pritë, s'na e del njeri, për të bërë ndonjë dredhi që turbullon gjendjen, s'na e ka kush shokun. Miqtë ore miqtë na mësuan të përmbysim mallin. Po ç'e do, na doli ai i mallëkuar inxhinier, pa e shikonin se si shpëtonin ata të pesëmbëdhjetë punëtorët. Do të vdisnin si miu në vrimë.

— Dhe Çupi bukur e lojti pjesën.

— Bukur, ore, bukur, po nuk më ngrohu shumë, më duket se e mori pak me frikë atë rrugë.

— Kishte nipin në vrimë.

— Për nip që e ka. Se mos e do Çupi atë mistrec. Por për këtë duhej të ngrinte qeverinë më këmbë, të kërkonte dënimin e teknikut.

— Ja preu yryshin Gjergji.

— Ai maskara fut hundët kudo. I pari që do të rjep, ai do të jetë.

Pasi mbaruan së ngrëni, prifti u ngrit.

— Kështu — foli Cani; — puna ime tani është: ditën e caktuar të shkoj te Përroi i Keq të takohem me miqtë. Puna jote: të shtrëngosh pas vetes Çupin, ta nxitësh dhe ta bindësh t'i vërë flakën zyrave të kooperativës.

— Po, kjo është puna ime.

— Jo vetëm kjo. Mallëko në kishë satanë, që u ngrit kundër Krishtit. Njerëzit, që të dëgjojnë, e marrin vesh së cilin mallëkon. Ti e di, se ata që besojnë te zoti, i tremben fjalës sate. Folë pa frikë për ditën e «kiametit» dhe për ditën e gjyqit të madh.

— Kam folur dhe do të flas.

— Të flasësh dhe më fort. Kot nuk qëndruam këtu.

Hëna ishte e plotë. Shpesh ajo fshihej prapa reve të rralla, që ishin shpërndarë si shtëllunga leshi. Asgjë s'levizte veç gjethit, që kërciste prej filladit.

Cani e hodhi vështrimin larg, sikur deshi të gërmonte diku në errësirë. Një grumbull gurësh të thatë dhe të shplarë nga koha zbardhëllyen para syve të tij dhe ju dukën si dele të bardha.

U zvarrit si gjarpër poshtë përroit. Pushi pak. Mbajti vesh, pastaj zuri të ngjitej. Vërejti rreth e qark. Përsëri mbajti vesh. Qetësi. Eci dhe pak...

U ndal në mes të grumbullit të gurëve e filloi të kërkonte në truallin e thatë. E gjeti. Tre gurë të vegjël, si tre vezë, ishin vendosur si perusti. Mori frymë lirisht dhe u gjallërua. Të priste? Jo!.. Ai për këtë kishte ardhur. Pëlliti si lopë...

Nuk vonoi. Dy burra të armatosur qëndruan para Canit. Njeri prej tyre, më i gjati, bëri një hap përpara dhe i tha:

— Kush je ti?

Cani, duke pasur shikimin te burri i dytë, që mbante armën gati për shkrepje, u përgjegj:

— Unë jam Cani. Nuk më njihni?

Burri me trup të gjatë qeshi.

— Kush të ka dërguar këtu?

— Don Pavli.

— Mirë, o Can. Dhe ne për ty kemi ardhur. Ulu, të bisedojmë shtruar dhe si u ka hije burrave...

Can, duke larguar frikën që i lindi në çastet e para të këtij takimi me dy miqtë e tij, filloi të qetësohej dhe të bisedonte hapur.

— Kam kohë që nuk kam biseduar me zëmër të hapur. Po vuaj për miq...

Të dy burrat, që ndodheshin ballë tij, lëvizën kokën në shenjë pohimi.

Can vazhdoi duke dredhur cigaren:

— E kam pritur ditën e këtij takimi si ditën e pashkës. I falënderoj kryetarët tanë, që mendojnë kaq shumë dhe për ne këtu...

Njëri nga burrat e armatosur e pyeti:

— Kryetarët mendojnë shumë për ty, po ti ç'ke bërë për ta?

Can u zgërdhi:


— Pak, shumë pak. Kam pritur urdhëra për të shtuar radhët.

— Pikërisht për këtë të kemi thirrur — tha përsëri ai burri i parë.

Can fërkoi duart i gëzuar:

— Këtë s'e kisha menduar, kam menduar tjetër gjë...

— Na trego ç'ke menduar.



— Një shembje të dytë, të përmbysim malin nga themelet.

— Nuk e ke keq. Tani ti do të vish me ne. Do të ikim prej këtej dhe brenda një kohe të shkurtër do të mësosh se si përmbysët mali nga themelet...

— Të vij dhe unë me ju?

— Qysh tani do të nisemi.

— Po miqtë nuk dinë gjë për këtë.

— Nisemi — shtoi burri tjetër.

Canit ju muar fryma nga kjo kërkesë e befasishme. U ngrit me përtim. Burri, që foli i fundit, e kapi nga nyja e dorës. Cani lëshoi një klithmë therëse dhe u përplas përtoke...

Një orë më pas ai qëndronte kokëvarur para Vullnetit.

Në agim, aty nga ora pesë, para Vullnetit qëndruan të lidhur: Krosi, Don Pavli, Çupi...

Këtu gjyshja Marë i dha fund ngjarjes. U hodhi një vështrim të ëmbël fëmijëve, që ishin emocionuar nga tregimi. Secili donte të pyeste gjyshen.

— Ç'ja u paskan bërë mirë — u hodh Gimi. — Apo jo, gjyshe?

— Kështu e kanë pësuar të gjithë armiq-

të dhe ata njerëz që janë ngritur kundër këtij pushteti — tha gjyshja Marë, — se në roje të kësaj toke jemi të gjithë ne, luftojnë dhe e mbrojnë trima të urtë, si Vullneti...

— Po Gjergji ç'u bë, ku është tani? — pyeti me kuriozitet Teuta.

— Pas ngjarjes që ju tregova, partia e dërgoi në shkollë dhe doli inxhinier. Një inxhinier që nuk e ka shokun. Ai sot e kësaj dite punon atje, atje ku e thërret atdheu...

F u n d

56616

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER